

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2495/3 Prot.

Durrës, më 2 . 12 .2025

V E N D I M

Nr. 106 , Datë 2 . 12 .2025

P Ë R

"MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, DOKTORATË NË "MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE DHE STUDIME EVROPIANE" PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI ME DIPLOMË TË DYFISHTË ME UNIVERSITETIN "BABES-BOLYAI" CLUJ NAPOCA, RUMANI, PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin e UAMD-së; në Rregulloren e UAMD-së; vendimit të Senatit Akademik nr.167, datë 27.11.2025, Bordi i Administrimit

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane" Program i Përbashkët Studimi me Diplomë të Dyfishtë me Universitetin "Babes-Bolyai" Cluj Napoca, Rumani, pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë sipas tabelës bashkëlidhur.